


Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË FONDIT PËR SIGURIME SHËNDETËSORE PËR VITIN 2022

**Prishtinë, qershor 2023**

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

1 Opinioni i Auditimit

2 Gjetjet dhe rekomandimet

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Fondit për Sigurime Shëndetësore për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.[1]

### Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Fondit për Sigurime Shëndetësore (FSSH), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera[2], për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Fondit për Sigurime Shëndetësore, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

### Baza për Opinion të Kualifikuar

A1 Përfshirja e faturave të pranuara në vlerë 4,308,262€ të pacientëve që kishin përfunduar trajtimet shëndetësore në regjistrin e detyrimeve kontigjente, ka shkaktuar mbivlerësimin e kësaj kategorie dhe nënvlerësim e kategorisë së detyrimeve të papaguara në PFV.

A2 Mbivlerësim i regjistrit të detyrimeve kontigjente për vlerën prej 505,900€ si rezultat i përfshirjes së lëndëve që i takojnë detyrimeve financiare dhe lëndëve që janë paguar dhe nuk paraqesin asnjë lloj detyrimi. Në anën tjetër ky regjistër ishte nënvlerësuar për 138,447€ për shkak të mosprezantimit të detyrimeve nga vitet paraprake dhe një detyrimi kontigjent të pranuar në vitin 2022.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Fondit për Sigurime Shëndetësore kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara te auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## Baza për konkluzion

B1 Në 33 raste në vlerë 574,433€, FSSH nuk kishte arsyetuar mjetet për Trajtime Mjekësore jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## Theksimi i Çështjes

1 Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se me kërkesë të Fondit për Sigurime Shëndetësore (FSSH), në vendimin e datës 25.10.2022 të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), ishin konstatuar mos – përputhshmëri të detyrimeve kontigjente në Programin për Trajtim Jashtë Institucioneve Publike (TMJISHP) dhe për këtë arsye nga Ministri i Financave ishte kërkuar auditimi i mospërputhshmërive të detyrimeve që dalin nga ky program në raport me legjislacionin për menaxhimin e financave publike.
Ne kemi audituar këtë program në kuadër të fushëveprimit financiar dhe të pajtueshmërisë, përmbajtja e të cilit është paraqitur në këtë raport, derisa në një raport tjetër të veçantë është duke u trajtuar nga aspekti i performancës dhe menaxhimit të këtij programi.
FSSH, në pasqyrat financiare të vitit 2022 ka shpalosur detyrime totale në vlerë prej 31,838,863€ nga të cilat 2,855,510€ ishin detyrime financiare, ndërsa 28,983,353€ prej tyre ishin detyrime kontigjente. Në vlerën e detyrimeve kontigjente ishin përfshirë detyrimet 26,268,807€ që rrjedhin nga fletë zotimet e lëshuara nga programi për TMJIShP, detyrimet 2,527,631€ nga lëndët e rregullta që janë në pritje për shqyrtim nga Bordi Ekzekutiv për TMJIShP dhe detyrimet 186,915€ nga paditë gjyqësore .
Po ashtu, ishin shpalosur edhe mjetet prej 176,443€ të mbetura pa shpenzuar në institucione shëndetësore për pacientet me trajtim jo emergjent, shërimi i të cilëve kishte kushtuar me pak se pro fatura e miratuar/paguar. Përmes Komisionit të Barazimeve të themeluar nga FSSH për këtë qëllim, këto mjete të mbetura shfrytëzohen për pacientet aktual që trajtohen në këto institucione përmes thyerjes së llogarive/faturave , apo mbeten si mjete të lira të cilat institucionet përkatëse shëndetësore duhet t'i kthejnë në llogarinë e thesarit.
Ashtu siç shpjegohet në raportin e auditimit, auditimi ynë konstaton nëse pasqyrat financiare të entitetit janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Në raportet tona të auditimit të FSSH ndër vite, përfitimet nga programi TMJISHP nuk janë trajtuar në kuadër të standardit SNKSP 19 Provizionet, Detyrimet dhe Pasuritë kontingjente, për faktin se ky standard i përjashton ndihmat sociale nga objekti i tij i trajtimit. Deri tani nuk kishte standard specifik që i rregullonte këto lloj përfitimesh, derisa nga viti 2023 hyn ne fuqi standard i ri SNKSP 42- Përfitimet Sociale, i cili i rregullon ndihmat sociale, ku hyn edhe trajtimet që i subvencionon FSSH. Kërkesë e këtij standardi është që entiteti duhet të bëjë vlerësim të detyrimeve të cilat mund të rezultojnë me dalje të mjeteve financiare dhe nga ai vlerësim të njohë drejtpërdrejt si detyrime rastet të cilat pritet të materializohen së shpejti.

Opinioni i auditimit nuk është modifikuar për shkak të  kësaj çështje

## Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të FSSH-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të FSSH-së  është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryesuesja e Bordit Drejtues të FSSH-së është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondit për Sigurime Shëndetësore.

### Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Fondit për Sigurime Shëndetësore është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Fondit për Sigurime Shëndetësore në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.[3]

### Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Fondit për Sigurime Shëndetësore me kriteret e përcaktuara te auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.

- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Fondit për Sigurime Shëndetësore.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

# 2 Gjetjet dhe rekomandimet[4]

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me shtatë rekomandime, prej tyre pesë janë rekomandime të reja dhe dy rekomandime të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

**Çështja A1 - Mos njohje e faturave të pranuara si detyrime financiare duke i raportuar ato në regjistrin e detyrimeve kontigjente**

| | |
|---|---|
| **Gjetja** | Sipas nenit 3 të Rregullës financiare nr.02/2013 MF për raportimin e detyrimeve të papaguara, Zyrtari Kryesor Financiar i organizatës buxhetore është përgjegjës për regjistrimin e të gjitha faturave ose detyrimeve tjera në SIMFK në përputhje me Rregullat KMF brenda tri ditëve të punës pas pranimit të faturës ose ngritjes së detyrimit përkatës. Më tutje, sipas UA 03/2017 për Trajtim Mjekësor jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike – Neni 5, paragrafi 6,procedurat administrative për raste emergjente duhet të përfundohen në pajtim me këtë udhëzim në afat sa më të shkurtër kohor, ndërkaq ekzekutimi i pagesës mund të marr kohë deri në gjashtë muaj.<br><br>Nga 150 mostrat e testuara të fletëzotimeve të lëshuara për rastet emergjente në vlerë prej 11,175,261€, kemi vërejtur se në 80 mostra, FSSH nuk i kishte evidentuar në regjistrat e detyrimeve të papaguara faturat e pranuara në vlerë 4,308,262€ të pacientëve që kishin përfunduar trajtimet shëndetësore dhe kishin sjellë raportet mjekësore e financiare, ashtu siç kërkohet me rregullën financiare. Këto lëndë nuk ishin shqyrtuar nga Bordi për TMJSHP edhe pse i kishin plotësuar kushtet administrative dhe financiare për aprovim. Këto lloje të detyrimeve figuronin në regjistrin e detyrimeve kontigjente me shuma të pro faturave dhe të njëjtat ishin prezantuar edhe në PFV.<br><br>Kjo kishte ndodhur për shkak se FSSH në regjistrat e detyrimeve të papaguara kishte evidentuar vetëm lëndët për të cilat është marrë vendimi për aprovim nga Bordi për TMJSHIP dhe duke qenë se këto lëndë nuk ishin shqyrtuar ende nga Bordi edhe pse i kishin plotësuar kriteret për aprovim, këto kishin mbetur pa u prezantuar si detyrime. |
| **Ndikimi** | Mosnjohja me kohë e detyrimeve do të jetë barrë e buxhetit të ardhshëm |

dhe ka ndikuar në raportim jo të saktë dhe të drejtë të detyrimeve në PFV. Kjo po ashtu ka ndikuar në krijimin e borxheve të mëdha ndaj spitaleve private, e kjo mund të rrezikoj që spitalet të ndërpresin ofrimin e mëtejshëm të shërbimeve për qytetarët bazuar në fletëzotimet e FSSH, duke shkaktuar për ta një barrë të madhe financiare, marrë parasysh kostot e larta të këtyre shërbimeve.

**Rekomandimi A1** Bordi Drejtues dhe Drejtori i Fondit, duhet të sigurojë se është bërë një analizë e regjistrit të detyrimeve kontigjente për t'u identifikuar të gjitha lëndët për të cilat janë përmbushur kriteret për njohjen e detyrimeve. Të njëjtat të shqyrtohen në kohë sa më të shkurtër nga ana e Bordit për TMJISHP dhe të evidentohen në regjistrat e detyrimeve të papaguara, në mënyrë që të mundësohet raportim i drejtë i tyre në PFV .

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja A2 - Mbivlerësim/Nënvlerësim i regjistrit të detyrimeve kontigjente**

**Gjetja** Sipas nenit 18 të Rregullores MF Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore "Organizatat buxhetore në harmoni LMFPP raportojnë të gjitha detyrimet kontigjente".

Nga testimi i regjistrit të detyrimeve kontigjente kemi vërejtur se, FSSH kishte mbivlerësuar këtë regjistër për 505,900€ duke përfshirë në këtë regjistër lëndë të cilat i takojnë detyrimeve të papaguara në vlerë 265,900€ dhe lëndë të cilat veçse ishin paguar dhe nuk paraqesin asnjë lloj detyrimi në vlerë 240,000€.

Më tutje, regjistri i detyrimeve kontingjente ishte nënvlerësuar për 128,321€, si rezultat i mos përfshirjes së detyrimeve ekzistuese të vitit 2020 nga rastet e procedurave gjyqësore. Kjo gjetje ishte prezantuar edhe në raportin e auditimit të FSSH për vitin 2021.

Për më shumë ky regjistër ishte nënvlerësuar edhe për shkak të mospërfshirjes së një detyrimi kontigjent të pranuar në vitin 2022 në vlerë 10,126€ të cilin e kemi identifikuar përmes regjistrit të protokolit. Si rezultat i kësaj, detyrimet kontigjente ishin nënvlerësuar në PFV për këtë vlerë.

Përfshirja e lëndëve që nuk duhej të ishin pjesë e regjistrit të detyrimeve kontigjente ka ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme në departamentin e TMJISHP me rastin e evidentimit të lëndëve përkatëse. Derisa mospërfshirja e lëndëve nga procedurat gjyqësore ka ndodhur si rezultat i moskordinimit mes FSSH dhe Ministrisë së Shëndetësisë (MSH) për identifikim e saktë të detyrimeve që ju takojnë, duke qenë se informatat për këto lloj detyrime figurojnë si të përbashkëta në regjistrat e Avokaturës Shtetërore dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

**Ndikimi** Përfshirja e lëndëve që nuk paraqesin asnjë lloj detyrimi dhe lëndëve që i takojnë detyrimeve financiare në regjistrin e detyrimeve kontigjente shkakton mbivlerësimin e këtij regjistri dhe nënvlerësimin e detyrimeve të papaguara. Nga ana tjetër, mos përfshirja e të gjitha lëndëve të detyrimeve kontigjente rezulton me nënvlerësim të këtij regjistri. E gjithë kjo ndikon në mos raportim të saktë dhe të drejtë të këtyre zërave në PFV.

**Rekomandimi A2** Bordi Drejtues dhe Drejtori i Fondit, duhet të sigurojë një rishikim detaj të

regjistrit të detyrimeve kontigjente dhe një krahasim me të gjitha vendimet e Bordit për t'i larguar nga ky regjistër lëndët të cilat veç se janë paguar dhe ato për të cilat ekzistojnë detyrimet financiare, në mënyrë që vlera e këtij regjistri e raportuar ne PFV të jetë e saktë dhe e drejtë. Po ashtu nevojitet bashkërendim me MSH-në  për t'i identifikuar  të gjitha lëndët që i takojnë FSSH-së, me qëllim të sigurimit të plotësisë, saktësisë se informatave financiare dhe raportimit të drejtë të tyre në PFV.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

**Çështja B1 - Mos arsyetim i mjeteve për trajtimet mjekësore të subvencionuara**

| | |
|---|---|
| **Gjetja** | Sipas Udhëzimit Administrativ (UA) 03/2017 për Trajtim Mjekësor Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike (TMJISHP) neni 5.5 “Drejtori i Fondit lëshon fletë zotimin për mbulim të shpenzimeve për trajtimin mjekësor sipas kritereve të përcaktuara me këtë UA”. Sipas fletë zotimit FSSH zotohet për përmbushje të detyrimit financiar ndaj institucionit në momentin e përfundimit të procedurave administrative në bazë të fletë lëshimit dhe të faturës së shpenzimeve nga institucioni. Gjithashtu sipas të njëjtit UA neni 6.1.5 “Brenda tre ditësh pas ekzekutimit të pagesës, divizioni për TMJISHP njofton palën për tërheqjen e vendimit ndërsa sipas nenit 6.1.7 “Procedura administrative përfundon me certifikim të pagesës dhe dorëzimin e vendimit për palën. Sipas vendimit pacientët përfitues të programit për TMJISHP, obligohen që pas trajtimit, të sjellin faturat e shpenzimeve të mjekimit nga institucioni gjegjes<br><br>Nga 38 mostrat e testuara të pagesave për TMJISHP për rastet e rregullta ose jo urgjente, 33 pacient nuk i kishin dorëzuar dëshmitë e trajtimit të subvencionuar. Vlera financiare për rastet të cilat nuk i kishin dorëzuar dëshmitë e trajtimit është 446,429€. Kjo e gjetur po përsëritet vit pas viti në raportet e auditimit për FSSH-në. |
| **Ndikimi** | Mungesa e një mekanizmi që t’i obligojë pacientët për arsyetimin e plotë të shpenzimeve për TMJISHP shkakton vështirësi në menaxhimin e shpenzimeve dhe rrezikojnë arritjen e qëllimit të synuar për këto shpenzime. |
| **Rekomandimi B1** | Bordi Drejtues dhe Drejtori i Fondit, duhet të krijojnë mekanizma efektiv për të siguruar se palët përfituese janë duke i respektuar detyrimet për arsyeshmërinë e plotë të shpenzimeve të subvencionuara. |

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.3.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunali në vitin 2022 ishte 266,252€, prej tyre ishin shpenzuar 204,332€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me pagesa të qirasë për objektin me qira, sigurimin e ndërtesës, mirëmbajtje dhe riparimin e automjeteve si dhe shpenzime të tjera. Për këtë kategori kemi testuar 17 mostra në vlerë prej 42,851€.

**Çështja A3 - Mos-Protokollimi i faturave**

| | |
|---|---|
| **Gjetja** | Rregullorja nr. 01/2013 për shpenzimin e parasë publike, neni 24, paragrafi 1.3, përcakton se faturat e pranuara duhet të protokollohen dhe të evidentohen në librin e faturave.<br><br>Nga 17 mostrat e testuara të mallrave dhe shërbimeve kemi vërejtur se në katër prej tyre në vlerë totale prej 15,620€, faturat nuk ishin protokolluar.<br><br>Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve me rastin e pranimit të faturave. Gjatë kohës që ishim në auditim FSSH na ka ofruar dëshmi se ka filluar të bëjë protokollimin e faturave. |
| **Ndikimi** | Mos protokollimi i faturave me rastin e pranimit të tyre rrezikon që faturat e njëjta të pranohen dhe paguhen më shumë se një herë. |
| **Rekomandimi A3** | Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet sigurojë vendosjen e një sistemi efektiv të kontrollit për të siguruar se të gjitha faturat e papaguara protokollohen dhe evidentohen. |

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B2 - Mangësi në procedimin e pagesave**

| | |
|---|---|
| **Gjetja** | Rregulla Financiare nr. 01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, neni 22, parasheh se fillimisht duhet të procedohet zotimi i mjeteve, lëshohet urdhër blerja, dhe pas pranimit të mallit bëhet raporti i pranimit, dhe më pas pranohet fatura.<br><br>Nga testimi i 17 mostrave për mallra dhe shërbime, në katër raste në vlerë prej 2,979€ urdhër blerja është lëshuar pas pranimit të faturës.<br><br>Shkaku i dobësive në procedimin e pagesave ka ndodhur si rezultat i kontrolleve të dobëta në procesin e realizimit të blerjeve. |
| **Ndikimi** | Mos aplikimi i procedurave të duhura të kontrollit gjatë procesit të pagesave, mund të ndikojë që FSSH mos t'i kryej detyrimet e faturuara me kohë, dhe rrjedhimisht në rritjen e detyrimeve të papaguara, të cilat do të jenë barrë për buxhetin e vitit pasues. |
| **Rekomandimi B2** | Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të forcoj kontrollet e |

brendshme, për të siguruar se pagesat janë në përputhje me procedurat dhe të parandalojnë rreziqet për vonesa apo detyrime të pa paguara.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.3.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 167,787€, pasurive jokapitale është 27,531€, si dhe e stoqeve 67,299€. Kemi testuar në total pesë mostra për testim substancial dhe pajtueshmëri.

**Çështja A4 - Mos-përdorimi i pasurisë se blerë**

**Gjetja**

Sipas Rregullores 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 3, paragrafi i Stoqeve, specifikon se Stoqe nënkupton pasurinë jo financiare e cila mbahet si pajisje rezervë apo material zyre e cila nuk është shpërndarë te personeli për përdorim.

Gjatë ekzaminimit fizik kemi vërejtur se në regjistrin e stoqeve që nga viti 2020 janë të evidentuara 44 pajisje të TI-së (monitor dhe Kompjuter) në vlerë totale 33,496€, pajisje që nuk janë në përdorim, pavarësisht se ato nuk janë pjesë rezervë. Këto pajisje ishin blerë në vitin 2019, duke u bazuar në numrin e stafit të aprovuar me buxhetin e atij viti. Në buxhetin e vitit 2019 kishin qenë të planifikuar 98 të punësuar, ndërsa në atë të vitit 2020, ky numër ishte reduktuar në 52 të punësuar. Në momentin e regjistrimit të tyre në regjistrin e pasurisë do të aplikohet zhvlerësimi për katër vite bazuar në datën e blerjes dhe si rezultat, vlera e tyre në PFV do të jetë zero. Për më tepër vendosja në përdorim në vitet vijuese mund të mos sjell asnjë përfitim marrë parasysh ndryshimet e shpejta të teknologjisë.

Kjo kishte ndodhur për shkak se me Ligjin e Buxhetit të vitit 2020, FSSH-së i ishte reduktuar numri i personelit të aprovuar me Ligjin e Buxhetit të vitit 2019.

**Ndikimi**

Mbajtja e pajisjeve pa u shfrytëzuar për një kohë të gjatë ndikon në zhvlerësimin me kohë të këtyre pajisjeve marrë parasysh trendin e përparimit teknologjik. Shpenzimet për pajisje në mungesë të përfitimeve të marra prej tyre janë barrë e buxhetit dhe dëmtojnë objektivat e synuara.

**Rekomandimi A4**

Bordi Drejtues dhe Drejtori i Fondit duhet të sigurojë se për pajisjet që nuk janë në përdorim duhet të analizohet mundësia për ta përdorur në organizatë, e nëse nuk i plotësojnë nevojat për përdorim të brendshëm, të gjinden alternativa tjera për trajtimin e këtyre pasurive.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja A5 - Dobësi në menaxhimin e pasurisë**

**Gjetja**

Sipas Rregullores Nr 02/2013 për menaxhimin e pasurisë, neni 6 pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”. Sipas nenit 19 te kësaj rregulloreje, raporti i inventarizimit duhet të përgatitet para përgatitjes së PFV-ve në mënyrë që komisioni i inventarizimit të ketë mundësinë e krahasimit të gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare.

FSSH gjatë vitit 2022 nuk kishte përdorur sistemin e-pasuria për regjistrimin dhe mirëmbajtjen e pasurive nën 1000€ dhe stoqeve. Vlera e pasurive jo

kapitale nën 1000€ ishte 27,531€, ndërsa vlera e stoqeve ishte 67,299€. Të dhënat për pasuritë nën 1,000€ mbahen në data bazë të brendshme në formë të Excel-it. Për më shumë, si rezultat i mos-përdorimit të sistemit e-pasuria në dy raste kishte gabime në zhvlerësimin e pajisjeve të IT-së (ku si rrjedhojë pasuria ishte nënvlerësuar për 275€ dhe regjistrime të gabuara të pasurisë) që kanë rezultuar me mbivlerësim të pasurisë në vlerë prej 700€.

Komisioni i inventarizimit kishte kryer inventarizimin e pasurisë mirëpo nuk e kishte bërë harmonizimin e raportit të inventarizimit me regjistrin e pasurive para përgatitjes së PFV-ve.

Kjo situatë ishte shkaktuar si rezultat i mos funksionimit të duhur të kontrolleve në fushën e menaxhimit të pasurive.

**Ndikimi**

Mirëmbajtja manuale e të dhënave dhe mos harmonizimi i gjendjes së pasurisë me regjistrin kontabël rrit mundësinë e gabimeve në mirëmbajtjen e regjistrave, shlyerjeve potenciale, keqpërdorimit, humbjes apo të tjetërsimit tyre. E gjithë kjo ndikon që vlera e pasurisë së pasqyruar në PFV të mos jetë e saktë dhe e drejtë.

**Rekomandimi A5**

Bordi Drejtues dhe Drejtori i Fondit, duhet të marrë të gjitha veprimet e nevojshme për të funksionalizuar sistemin e-pasuria duke i evidentuar dhe mirëmbajtur pasuritë nën 1,000€ dhe stoqet. Po ashtu duhet të sigurojë se harmonizimi i raportit të inventarizimit me regjistrat kontabël të pasurive, bëhet para përgatitjes së PFV-ve.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

# 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final[5] | 2022 Shpenzimet | 2021 Shpenzimet | 2020 Shpenzimet |
|---|---|---|---|---|---|
| **Burimet e fondeve** | **8,162,998** | **8,162,998** | **6,128,439** | **10,145,805** | **8,792,577** |
| Grante Qeveritare - Buxheti | 8,162,998 | 8,162,998 | 6,128,439 | 10,145,805 | 8,792,577 |

Buxheti përfundimtar në total nuk ka pësuar ndryshime në raport me buxhetin fillestar


Në vitin 2022 FSSH ka shpenzuar 77% të buxhetit përfundimtar me një zvogëlim prej 22% në krahasim me vitin 2021. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë:

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final | 2022 Shpenzimet | 2021 Shpenzimet | 2020 Shpenzimet |
|---|---|---|---|---|---|
| **Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike** | **8,162,998** | **8,162,998** | **6,128,439** | **10,145,805** | **8,792,577** |
| Pagat dhe mëditjet | 411,746 | 411,746 | 341,756 | 340,712 | 386,617 |
| Mallrat dhe shërbimet | 458,052 | 243,052 | 187,452 | 216,242 | 234,593 |
| Komunalitë | 23,200 | 23,200 | 16,880 | 18,989 | 17,695 |
| Subvencionet dhe transferet | 7,270,000 | 7,485,000 | 5,582,351 | 9,400,993 | 7,999,984 |
| Investimet Kapitale | 0 | 0 | 0 | 168,870 | 153,687 |

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:
• Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin nuk kishte pësuar ndryshime. Realizimi në këtë kategori ishte 83%;
• Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunali në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 215,000€. Kjo ulje ishte rezultat i transferit me vendim të qeverisë në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve. Realizimi i kesaj kategorie ishte 77%;
• Buxheti final për subvencione dhe transfere, në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 215,000€. Kjo rritje ishte rezultat i transferit me vendime të qeverisë nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve. Realizimi i subvencioneve ishte vetëm 74 % e buxhetit final përkundër detyrimeve të mbetura pa paguar në vlerë prej që 2,838,505€ të cilat i takojnë kësaj kategorie.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2022




Pranimet e realizuara në vitin 2022 nga FSSH në vlerë 128,723€ ishin nga mjetet e kthyera në buxhetin e RKS si rezultat i barazimeve të ndodhura me spitalet private për TMJIPSH në lidhje me pagesat paraprake të pa shpenzuara.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final | 2022 Pranimet | 2021 Pranimet | 2020 Pranimet |
|---|---|---|---|---|---|
| **Totali i të hyrave** | **33,125** | **33,125** | **128,723** | **57,201** | **50,907** |
| Të hyrat jo tatimore | 33,125 | 33,125 | 128,723 | 57,201 | 50,907 |

# 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2021 të FSSH ka rezultuar në tre rekomandime kryesore. FSSH kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2022, nuk ishte zbatuar asnjë rekomandim. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Raporti i FSSH për vitin 2021 është shqyrtuar në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe nga ky komision kanë rezultuar shtatë rekomandime. Ne kemi trajtuar nivelin e zbatimit të këtyre rekomandimeve nga ana e FSSH dhe kemi konstatuar se nga shtatë rekomandimet e dhëna, një rekomandim është zbatuar, pesë janë në proces të zbatimit dhe një nuk është zbatuar.

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**




**Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

| Nr | Fusha e Auditimit | Rekomandimet e vitit 2021 | Veprimet e ndërmarra | Statusi |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Pasqyrat Financiare Vjetore | Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë kontrolle më të forta në përgatitjen dhe prezantimin e informatave në PFV, në mënyrë që ato të prezantojnë gjendjen e plotë dhe të saktë të të gjitha zërave. | Çështja ka rezultuar e njëjtë edhe në këtë vit, andaj rekomandimi konsiderohet i pa zbatuar. Ky rekomandim është trajtuar të çështja A2- Mbivlerësim i regjistrit të detyrimeve kontigjente | Nuk është i aplikueshëm më |
| 2. | Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë | Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të forcoj kontrollet e brendshme, dhe nga zyrtarët përgjegjës të kërkoj zbatimin e procedurave, duke filluar nga inicimi i shpenzimeve deri në kryerjen përfundimtare të pagesave. | Çështja ka rezultuar e njëjtë.Si rezultat i kësaj, rekomandimi konsiderohet i pa zbatuar. | Nuk ka filluar zbatimi |
| 3. | Subvencionet dhe transferet | Bordi Drejtues dhe Drejtori i Fondit, duhet të krijojnë mekanizma efektiv për të siguruar se palët përfituese janë duke i respektuar obligimet për arsyeshmërinë e plotë të shpenzimeve të subvencionuara. Më tutje, kjo çështje të adresohet përmes ndryshimit të udhëzimit administrativ. | Çështja ka rezultuar e njëjtë.Si rezultat i kësaj, rekomandimi konsiderohet i pa zbatuar. | Nuk ka filluar zbatimi |

Bezad Halilaj, Zëvendës Auditor i Përgjithshëm



Agron Fetiu, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Blerina Krasniqi, Drejtore e Auditimit



Burbuqe Idrizi, Udhëheqëse e ekipit




Edon Kabashi, Anëtar i ekipit



Jehona Krasniqi, Anëtare e ekipit



# Shtojca I: Letër konfirmimi




**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo
*Qeveria-Vlada-Government*
*Fondi i Sigurimit Shëndetësor/Fond za Zdravstveno Osiguranje/Health Insurance Fond*

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2022 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Fondit për Sigurime Shëndetësore, për vitin 2022 (në tekstin e mëtejmë "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.




Me respekt

Bujar Kaçuri

Z.V. i Drejtorit të Përgjithshëm të FSSh-së,

Data: 16.06.2023, Prishtinë

# Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare[6] duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet[7], duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

**(shkëputur nga SNISA 200)**
***Forma e opinionit***

**Opinioni i pa-modifikuar**

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

### Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinioni i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinioni

### Opinioni i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financave;

b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose

c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

### Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

***Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit***

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

[1] Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik

[2] Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar

[3] Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet

[4] Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

[5] Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

[6] Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit

[7] Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.